VENDIM
Nr. 74, datë 23.5.2017

MBI KËRKESËN E OST SH.A. PËR RISHIKIMIN DHE KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S, NR. 52, DATË 6.4.2017, "MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 190, DATË 22.12.2016, TË BORDIT TË ERE-S, DERI NË 31.12.2017"

Në mbështetje të neneve 16, pika 5 të ligjit nr. 43/2015, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", si dhe nenit 16 të "*Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për rishikimin dhe korrigjimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 52, datë 6.4.2017, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017",

konstatoi se:

- ERE, me vendimin me nr. 52, datë 6.4.2017, vendosi "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017*".

- Me shkresën nr. 2256, Prot. datë 25.4.2017, OST sh.a. i kërkoi ERE-s rishikimin dhe korrigjimin e vendimit të bordit nr. 52, datë 6.4.2017, "*Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017",* në lidhje me tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017, si dhe detyrimit të OSHEE sh.a. për shlyerjen e detyrimeve korrente, si dhe detyrimeve të prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a.

- OST sh.a. ka paraqitur pretendimin që lidhet me mospërfshirjen në vendimin nr. 52, datë 6.4.2017, të bordit të ERE-s, të shlyerjes nga ana e OSHEE sh.a të detyrimeve të prapambetura ndaj OST sh.a., me qëllim shlyerjen e kredive nga OST sh.a., ashtu siç është parashikuar në vendimin e bordit të ERE-s me nr. 111, datë 1.7.2016, *"Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të bordit të Komisionerëve të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016 - 31 dhjetor 2016",* si dhe vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 22.12.2016, *"Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të bordit të Komisionerëve të ERE -s, vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, vendimit nr. 128, datë 29.7.2016, të Bordit të ERE-s deri në 31.3.2017*".

- ERE konstaton se, pavarësisht problemeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndaj shoqërisë OST sh.a., tarifa e transmetimit të energjisë elektrike llogaritet mbi bazë të të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë dhe jo mbi bazën e fluksit të mjeteve monetare.

- Në shkresën e MEI-t, nr. 682/2 Prot. datë 3.4.2017, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 *"Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", ka vlerësuar mbajtjen e të njëjtit regjim tarifor për vitin 2017 për të tria kompanitë, duke u shprehur ndër të tjera se kjo vendimmarrje ka jo vetëm rëndësi strategjike për sektorin, por edhe do të garantonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërive deri në përmbyllje të proceseve të nisura në kuadër të reformave sektoriale.

- Vendimi i ERE-s, nr. 52, datë 6.4.2017, në pikën 1 të tij ka përcaktuar shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, "*Për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohëshme të energjisë elektrike të miratuara me vendimet nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147 dhe nr. 148, datë 26.12.2014, të bordit të komisionerëve të ERE-s*".

- Në pikën 4, të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, përcaktohet se OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, duhet të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. dhe KESH sh.a. Sa më sipër zgjidh edhe shqetësimin e ngritur nga OST sh.a. për mosadresim në vendimin nr. 52, datë 6.4.2017, të bordit të ERE-s, të çështjes së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe atyre korrente.

- Sa më sipër, përcjellë nga shoqëria OST sh.a. nuk përbën provë të re dhe as konstatim të gabimeve materiale të tilla që të çojnë bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai nr. 52, datë 6.4.2017, "*Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017*".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe korrigjimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 52, datë 6.4.2017, "*Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017*".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimmarrjen e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti